



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bonuese të zonimit
Dt. 02.07.2026
Gjakovë

Në mbështetje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, në bazë të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.24/2015 Mbi Elementet, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, si dhe nenit 6 të Rregullores për Bonuset e Zonimit Nr.01-011/10-222625 dt.05.05.2025, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bonuset e zonimit thërret këtë:

TAKIM PUBLIK

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bonuese të zonimit, organizon takim publik të hapur me qytetarë të interesuar për trajtimin e kërkesës së **“HAB ENGEERING” SH.P.K** të parashtruar për bonuse të zonimit në lokacionin si vijon:

- Zona lindore e Komunës së Gjakovës - zona përgjatë rrugëve “Avdulla Babalija” “Marije Shllaku” dhe “Lumi Trakaniq” në parcela kadastrale me numër : **P-70705028-05879-0 Z.K. (gjendja e re) Gjakovë jashtë qytet, nga aplikuesi “HAB ENGEERING” SH.P.K** për ngritjen e Kompleksit të Banimit kolektiv dhe Afarizëm.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bonuse të zonimit, përmes kësaj shkrese informuese, informon banorët e zonës në mes të rrugëve “Avdulla Babalija” “Marije Shllaku” dhe “Lumi Trakaniq” e po ashtu dhe palët e interesit lidhur me procedurën e shqyrtimit të kërkesës për bonuese të zonimit të parashtruar nga **“HAB ENGEERING” SH.P.K** me qëllim të realizimit të Interesin Publik.

Qëllimi i këtij takimi është informimi i banorëve të zonës dhe palët e interesit lidhur me dhënien e bonuseve të zonimit me qëllim të realizimit të interesit publik, në lokacionin që përfshihet në: **Zona lindore e Komunës së Gjakovës, përkatësisht zona përgjatë rrugëve “Avdulla Babalija” “Marije Shllaku” dhe “Lumi Trakaniq” parcela kadastrale me numër: P-70705028-05879-0 Gjakovë-J-Qytet.**

Në këtë lokacion bazuar në dokumentin e planifikimit në fuqi është paraparë interesi publik, përkatësisht zgjerimi i rrugëve ekzistuese, e cila do të i shërbej interesit publik përkatësisht banorëve të zonës dhe në përgjithësi qytetarëve të Komunës së Gjakovës.

Projekti i propozuar parashikon zhvillimin e një kompleksi të banimit me elemente të integruara afariste në katin përdhese, duke synuar krijimin e një strukture urbane të organizuar dhe funksionale, në përputhje me karakterin dhe potencialin e zonës, i cili është bazuar në trajtimin e parcelës si një njësi e vetme zhvillimi, duke mundësuar një organizim të qartë të volumit ndërtimore, qarkullimit dhe hapësirave të jashtme, ku në shërbim të interesit publik Investitori do të përfitojë Bonuse të Zonimit në kuadër të projektit të prezantuar për Leje ndërtimore, në lokacionin e dhënë, të lëshuar nga DUMM, ku parashihet ndërtimi i objektit të banimit kolektiv sipas destinimit të përcaktuar me dokumentin e planifikimit hapësinor Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës 2024-2032, **ku përkitazi nga bonuset të cilat parashihet të jepen me qëllim të realizimit të interesit publik për hapjen e rrugës për interesat e banoreve të kësaj zone, parcela me nr. P-70705028-05895-2, me S= 28730m², e destinuar për Bonus, do të kaloj pronësi të Komunës së Gjakovës dhe do të ketë destinim hapjen e rrugës për interes të banorëve të kësaj zone.**

Takimi dëgjimor me qytetarët e interesuar do të mbahet datën 09.07.2026 në orën 11⁰⁰ në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjakovës.



K.K.GJAKOVË
Gjakovë ZK Gjakovë jashtë Qytet
Parcelë: 70705028-05879-1 dhe 05879-2

PLAN SITUACIONI

Veriu

-  Parcelë me numër
-  Lokacioni / objektet
-  Traseja e Rrugës
-  Vija e Rregullimit
-  Vija e Ndërtimit
-  Gjendja Faktike (objektet ekzistues)
-  Gjendja Kadastrale



P = 1:1000

Lokacioni për ndërtimin e objekteve të kategorisë II-4ë me karakter objektiv banor me afërteshmëri B+P+7 në B+P+11 dhe B+P+13 (sipas rregullorës për bonuset të zonimit) në parcelën kadastrale ndërtimore me nr. P-70705028-05879-1 dhe 05879-2, K.Gjakovë jashtë Qytet, sipas Hartës Zonale Komunale i vendosur në kërkesën për kushte të ndërtimit me nr. 07-351/02-24740 të dt. 02.06.2026

Vertetohet: GEO-KAD Gjakovë

Jeton Dalladaku inxh. dipl. ark.

Zyrtar i Lartë për Lepje të Ndërtimit